

## **SYLLABUS nga Klinika Juridike nga e drejta familjare dhe trashëgimore**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti Juridik</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Klinika Juridike nga e drejta familjare dhe trashëgimore</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Zgjedhore</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>II</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>5</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>Prishtinë</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. Ass. Dr. Bedri Bahtiri</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b>bedri.bahtiri@uni-pr.edu</b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<i>Lënda Klinika juridike nga e drejta familjare dhe trashëgimore është lëndë zgjedhore që mësohet në kuadër të plan programit të Fakultet Juridik të Universitetit të Prishtinës Hasan Prishtina në Prishtinë, e cila studion çështje nga dhuna në familje, urdhrin për mbrojtje dhe urdhrin për mbrojtje emergjente, masat mbrojtëse dhe procedurën gjyqësore lidhur me shqiptimin e masave mbrojtëse që ndërlihen me të drejtën familjare dhe masat preventive që duhet të ndërmerren me qëllim të mbrojtjes së familjes. Gjithashtu kjo lëndë studion procedurat në kontestet martesore, kompetencat e gjykatave në kontestet familjare dhe trashëgimore, format e vendosjes së gjykatës, mjetet e goditjes së zakonshme dhe të jashtëzakonshme kundër aktgjykimit dhe aktvendimit të gjykatës, procedurat e kundërshtimit të atësisë, procedurën e birësimit të fëmijëve, rregullimin e gjendjes personale të personave, procedurën për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore si dhe procedurën e bërjes së testamentit para noterit. Synohet që të kombinohen dijet teorike me dijet praktike, kështu që studentet aftësohen me shkathtësi praktike në përpilimin e akteve për fillimin e procedurës dhe mbarimin e saj.</i>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<b>Klinika juridike nga e drejta familjare dhe trashëgimore:</b> Qëllimi kryesor i lëndës Klinika juridike nga e drejta familjare dhe trashëgimore është që të njohë studentët me parimet themelore të së drejtës familjare dhe trashëgimore dhe zbatimin e tyre praktik në procedurën kontestimore me rastin e zgjidhjes së martesës apo të shqyrtimit të trashëgimisë, posaçërisht të parimeve të cilat zbatohen me procedurën e zgjidhjes së martesës dhe shqyrtimit të trashëgimisë si parimi i dispozicionit, parimi i provave dhe të provuarit, mjetet provuese,

	<p>objekti i të provuarit, barra e të provuarit, parimi i dëgjueshmërisë së të dyja palëve. Këto parime aplikohet drejt për drejtë gjatë ushtrimeve me studentet me rastin mbajtjes së gjykimeve të improvizuara. Ky qëllim arrihet edhe nëpërmjet detyrave praktike, ligjëratave, diskutimeve, leximit të materialeve të shpërndara gjatë ligjëratave dhe format tjera të të mësuarit. Lënda, gjithashtu synon mësimin praktik të studenteve me rastin e angazhimit të tyre drejt për drejtë në rolet të paditësit, të paditurit apo të gjykatësit gjatë gjykimeve të improvizuara. Ata aftësohen të shkruajnë padi, aktgjykime, vendime të ndryshme, ankesa si dhe mjete të jashtëzakonshme të goditjes, revizionin dhe kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Qëllimi themelor pra është që studentet të përgatiten për të gjitha veprimet juridike të palëve në procedurë para gjykatës. Në pjesën e parë studentet do të aftësohen për veprimet juridike që janë të domosdoshme të ndërmerren në procedurë gjatë mbajtjes së seancave gjyqësore, kurse në pjesën e dytë ata do të aftësohen për ti përpiluar mjetet e goditjes si dhe vendimet gjyqësore të gjykatës.</p>		
<p><b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b></p>	<p>Zhvillimi i logjikës juridike Kuptimi i materies, puna praktike dhe seminarët nga e drejta familjare dhe trashëgimore Zhvillimin e mënyrës së analizës dhe hulumtimit Pjesëmarrja interaktive dhe angazhimi në ligjërata, dhe Angazhimet në orët e ushtrimeve, me aplikimin e praktikave të tilla të nxënies priten rezultate maksimale në procesin e nxënies.</p>		
<p><b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënies të studentit)</b></p>			
<p><b>Aktiviteti</b></p>	<p><b>Orë</b></p>	<p><b>Ditë/javë</b></p>	<p><b>Gjithësej</b></p>
<p>Ligjërata</p>	<p>2</p>		<p>2</p>
<p>Ushtrime teorike/laboratorike</p>	<p>1</p>		<p>1</p>
<p>Punë praktike</p>	<p>1</p>		<p>1</p>
<p>Kontaktet me mësimdhënësin/konkultimet</p>	<p>1</p>		<p>1</p>
<p>Ushtrime në teren</p>	<p>/</p>		<p>/</p>
<p>Kollokfiume,seminar e</p>	<p>1</p>		<p>1</p>
<p>Detyra të shtëpisë</p>	<p>1</p>		<p>1</p>
<p>Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)</p>	<p>3</p>		<p>3</p>
<p>Përgaditja përfundimtare për provim</p>	<p>90</p>		<p>90</p>

Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	40	5	40
Projektet,prezentimet ,etj	1		1
<b>Totali</b>	<b>140</b>	<b>20</b>	<b>140</b>

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<p>Ligjërata interaktive, me ç ‘rast do të përfshihen edhe studentët në mënyrë që të zhvillohet logjika juridike teorike dhe praktike, argumentimi dhe prezantimi.</p> <p>Përgatitja e punimeve seminarike dhe prezantimi i tyre si dhe mbrojtja e punimit seminarik gjatë debatit me kolegët e tyre.</p> <p>Pjesa praktike do të përfshinë shqyrtimi i rasteve në mënyrë analitike, të problemeve nga fusha e së drejtës familjare dhe trashëgimore, duke përfshirë edhe studimin dhe përpilimin e vendimeve gjyqësore dhe parashtrësave të ndryshme. Shqyrtimi dhe zgjidhja e rasteve do të bazohet në të drejtën pozitive në Kosovë, duke mos i përjashtuar edhe krahasimet me të drejtat tjera pozitive.</p> <p>Ushtrimet, janë pjesë e mësimit nga e drejta familjare dhe trashëgimore, përmes të cilave studentët do të mësojnë më shumë rreth zbatimit praktik të së drejtës familjare dhe trashëgimore.</p>												
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<table border="1"> <tr> <td>Pjesëmarrja dhe angazhimi në orët e ligjëratave</td> <td>10 %</td> </tr> <tr> <td>Angazhimet në orët e ushtrimeve, puna praktike dhe seminarët</td> <td>10 %</td> </tr> <tr> <td>Testet/Kollokviumet</td> <td>30 %</td> </tr> <tr> <td>Provimi</td> <td>50 %</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> </tr> </table>			Pjesëmarrja dhe angazhimi në orët e ligjëratave	10 %	Angazhimet në orët e ushtrimeve, puna praktike dhe seminarët	10 %	Testet/Kollokviumet	30 %	Provimi	50 %		
Pjesëmarrja dhe angazhimi në orët e ligjëratave	10 %												
Angazhimet në orët e ushtrimeve, puna praktike dhe seminarët	10 %												
Testet/Kollokviumet	30 %												
Provimi	50 %												
<b>Literatura</b>													
<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Klinika juridike e drejta familjare dhe trashëgimore, Prof.Dr. Hamdi Podvorica, Ma. Fatlum Podvorica, 2015</li> <li>2. <i>Materiale dhe raste ngga praktika gjyqësore të siguruar nga profesori për studentët</i></li> </ol>												
<b>Literatura shtesë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. E drejta familjare, Prof. Dr. Hamdi Podvorica, Prishtinë, 2011;</li> <li>2. E drejta familjare, Prof. Dr. Arta Mandro, Tiranë, 2009</li> </ol>												

	<p>3. E drejta familjare, Prof. Dr. Sonila Omari, 2010</p> <p>4. E drejta familjare, Prof. Dr. Arta Mandro-Balili, Vjollca Meçaj, Tefta Zaka, Ariana Fullani, Tiranë, 2006.</p> <p>5. E drejta trashëgimore, Prof.Dr. Hamdi Podvorica, 2011.</p> <p>6. <i>Komentari i Ligjit për Familjen dhe Komentarin e Ligjit të procedurës kontestimore.</i></p>
<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	<p>Studentët do të njoftohen me përmbajtjen e lëndës në përgjithësi, mënyrën e zhvillimit të mësimi gjatë semestrit dhe literaturën dhe do të vazhdohet me trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- dhuna në familje;</li> <li>- burimet e dhunës në familje;</li> <li>- masat ligjore për ndalimin e dhunës në familje.</li> </ul>
<b>Java e dytë:</b>	Rregullat e procedurës në kontestet lidhur me dhunën në familje, kërkesa për urdhër mbrojtje dhe kërkesa për urdhër mbrojtje emergjente, vendimet e gjykatës lidhur me shqiptimin e masave mbrojtëse të viktimës së dhunës në familje.
<b>Java e tretë:</b>	Procedura në kontestet martesore, parimet e procedurës, kompetencat e gjykatës dhe masat e përkohshme.
<b>Java e katërt:</b>	<p>Padia zgjidhjen e martesës dhe propozimi për zgjidhje të martesës me marrëveshje të përbashkët të bashkëshorteve, shkaqet e zgjidhjes së martesës dhe aktgjykimi për zgjidhje të martesës.</p> <p>Shkaqet e pavlefshmërisë absolute dhe relative të martesës dhe procedura për zgjidhje të martesës me anulim</p>
<b>Java e pestë:</b>	Mjetet e zakonshme të goditjes, ankesa kundër aktgjykimit dhe aktvendimit, procedura sipas ankesës dhe vendimet e gjykatës së shkallës së dytë sipas ankesës kundër aktvendimit dhe aktgjykimit.
<b>Java e gjashtë:</b>	Kollokviumi i parë
<b>Java e shtatë:</b>	Mjetet e jashtëzakonshme të goditjes kundër aktgjykimit dhe aktvendimit të formës së prerë, revizioni, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë.
<b>Java e tetë:</b>	Procedura e kundërshtimit të atësisë, parimet e procedurës administrimi i provave dhe vërtetimi i atësisë me vendim të gjykatës.
<b>Java e nëntë:</b>	Procedura e birësimit të fëmijëve pa përkujdesje prindërore apo përkujdesja e të cilëve është lënë pas dore.

<b>Java e dhjetë:</b>	Themelimi i birësimit, kompetenca e gjykatës, periudha provuese dhe pasojat e anulimit dhe shuarjes së birësimit.
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Rregullimi i gjendjes personale të personave, heqja e plotë dhe e pjesshme e zotësisë për të vepruar.
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Kompetenca territoriale, lëndore dhe funksionale e gjykatës për heqjen e zotësisë së plotë dhe të pjesshme për të vepruar, subjektet e procedurës dhe dhënia e aktvendimit për heqjen e plotë dhe të pjesshme të zotësisë për të vepruar
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Testamenti noterial, përmbajtja e testamentit, revokimi i testamenti dhe zotësia për të bërë testamentin noterial.
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, zbatimi i rregullave të procedurës jokontestimore në shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, veprimet paraprake dhe përpilimi i aktvendekjes. Emërimi i kujdestarit të përkohshëm të pasurisë trashëgimore, inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë trashëgimore, shpallja e testamentit, heqja dorë nga trashëgimia, ndërprerja e procedurës dhe udhëzimi në procedurë kontestimore dhe aktvendimi për trashëgimin.
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Provimi përfundimtarë

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
<p><b><i>Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UP-së.</i></b></p> <p><b><i>Stafi akademik dhe studentët duhet tu përmbahen akteve normative të Fakultetit Juridik dhe të UP-së – Hasan Prishtina në Prishtinë dhe të përmbushen detyrat e tyre në pajtim me këto akte dhe norma ligjore, me ndërgjegjshmëri në mënyrë që të kontribuojnë edhe në realizimin e projekteve kërkimore shkencore.</i></b></p> <p><b><i>Studentët janë të obliguar që të vijojnë ligjëratat, ushtrimet si dhe të gjitha aktivitetet gjatë gjithë semestrit.</i></b></p>